



# **Demokratska Stranka Bošnjaka - DSB**

**Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorit të Pavarur**

**01 Janar 2023 - 31 Dhjetor 2023**

**Përmbajtja:**

Raport i auditorëve të Pavarur.. .....	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	6
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	7
Informata të përgjithshme .....	8
Shënimet e pasqyrave financiare.....	9 - 14

# Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë së Demokratska Stranka Bošnjaka - DSB

## Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

### Mohim i opinionit

Ne kemi audituar raportet financiare bashkëngjitura të Subjektit Politik “**Demokratska Stranka Bošnjaka - DSB**” (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “DSB”), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2023, Pasqyra e të Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në fq. 9-14.

Ne nuk shprehim një opinion mbi raportet financiare të vitit 2023 të subjektit politik “**Demokratska Stranka Bošnjaka - DSB**”. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkuara në paragrafin bazat për mohim të dhënies së opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të pasur një bazë për një opinion të auditimit.

### Baza për mohim të opinionit

- Subjekti Politik nuk ka plotësuar drejt Pasqyrën e pozitës financiare më 31 Dhjetor 2023 ( pasurinë, ekuitetin dhe detyrimet ), pasi që vlera prej -10,440.07 Euro si deficit nga viti paraprak në pozicionin Fondet e akumuluar nuk është bartur në vitin 2023, ashtu sic kërkohet me ligjin Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L- 058, me Ligjin Nr. 04/L-212 dhe me Ligjin Nr. 08/L-122, Neni 15 Raportimi Financiar.
- Ashtu siç është prezantuar në Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, kategoria Shpenzimet e fushatës, Subjekti Politik ka deklaruar vlerën prej 10,445.00 Euro gabimisht duke mbivlerësuar kështu shpenzimet për këtë vlerë, kur dihet se në vitin 2023 nuk ka pasur zgjedhje. Gjatë auditimit është konstatuar që këto janë pagesa ndaj detyrimeve për vëzhgues, të bartura nga fushatat e viteve paraprake, të cilat pjesërisht janë paguar gjatë vitit 2023 me një detyrim të mbetur më 31 Dhjetor 2023 në shumë prej 1,120.00 euro. Duke pas parasysh natyrën e shënimeve që mban subjekti politik ne e kishim të pamundur të përcaktojmë korigjimet e nevojshme më 31 Dhjetor 2023.
- Ashtu siç është deklaruar në Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, Të hyrat nga Donacionet dhe kontributet në të holla, Subjekti Politik gabimisht ka prezantuar si të hyra shumë prej 1,172.92 Euro, e cila faktikisht është shuma e mbetur si para e gatshme më 31 Dhjetor 2023 në llogarinë bankare të Koalicionit Vakant.
- Ashtu siç është deklaruar në Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, kategoria Shpenzimet për derivate, Subjekti Politik për shumicën e blerjeve të derivateve nuk ka dokumentacion relevant mbështetës si psh. fatura por vetëm kupona fiskal dhe vërtetime si autorizim për furnizim, pra nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, I Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L- 058, me Ligjin Nr. 04/L-212 dhe me Ligjin Nr. 08/L-122, Neni 15 Raportimi Financiar. Duke pas parasysh natyrën e shënimeve që mban subjekti politik ne e kishim të pamundur të përcaktojmë korigjimet e nevojshme më 31 Dhjetor 2023.

## **Theksim i çështjes**

Ne po ashtu tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik në Pasqyrën e Pozitës Financiar, pozicioni Paraja dhe ekuivalentët e parasë ka prezantuar vlerën prej 1,172.92 Euro, kjo vlerë figuron në llogarinë bankare të Koalicionit Vakati i cili përbëhet prej Subjektit Politik: Demokratska Stranka Bošnjaka dhe Subjektit Politik: Demokratska Stranka Vatan, pasi që Subjekti Politik DSB nuk posedon llogari bankare aktive.
- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet të mirëfilltë për ti mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas Standardeve të Kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Subjekti Politik në blerjet e kryera nuk ka aplikuar ndonjë procedure të tenderimit e cila do të mundësonte një shfrytëzim sa më efikas, me kosto ekonomike, transparente dhe të drejtë të fondeve të subjektit politik.
- Subjekti Politik nuk e ka të definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjësisë për transaksione financiare, ashtu siç parashihet në ligjin Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, I Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L- 058, me Ligjin Nr. 04/L-212 dhe me Ligjin Nr. 08/L-122, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti Politik i ka kryer të gjitha transaksionet përmes llogarisë bankare të Koalicionit Vakati, po ashtu edhe detyrimet ndaj ATK janë kryer përmes të njëjtës llogari (numri fiskal) për të dy Subjektet Politike DSB dhe DSV.
- Ashtu siç është prezantuar në Pasqyrën e Pozitës Financiar, pozicioni Huatë e pagueshme, Subjekti Politik nuk e ka plotësuar tabelën Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera për vlerën prej 1,120.00 Euro e cila kërkohet që të shpaloset me ligjin Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, I Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L- 058, me Ligjin Nr. 04/L-212 dhe me Ligjin Nr. 08/L-122, Neni 15 Raportimi Financiar.

## **Çështje tjera**

Pasqyrat financiare të subjektit politik për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2022 janë audituar nga auditor tjetër, opinioni i të cilëve mbi këto pasqyra ka qenë i pa kualifikuar.

## **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin 08/L-122 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-212 dhe me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalojen, sipas rastit,

te çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitetit sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

### **Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.



---

Haxhi Nimanaj  
Auditor Ligjor  
21 Qershor 2024

## Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Me 31 Dhjetor 2023	Me 31 Dhjetor 2022
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet	5	0.00	0.00
Pasuritë e paprekshme		0.00	0.00
Pasuritë tjera afatgjata		0.00	0.00
<b>Total pasuritë afatgjata</b>		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Pasuritë afatshkurtra</b>			
Llogaritë e arkëtueshme		0.00	0.00
Parapagimet		0.00	0.00
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	7	1,172.92	4.93
Pasuritë tjera afatshkurtra		0.00	0.00
<b>Total pasuritë afatshkurtra</b>		<b>1,172.92</b>	<b>4.93</b>
<b>Total pasuritë</b>		<b>1,172.92</b>	<b>4.93</b>
<b>Ekuiteti</b>			
Fondet e akumuluar		0.00	4.93
Suficiti / (deficiti) i vitit		52.92	(10,445.00)
<b>Total Ekuiteti</b>		<b>52.92</b>	<b>(10,440.07)</b>
<b>Detyrimet</b>			
<b>Detyrimet afatgjata</b>			
Huatë e pagueshme		0.00	0.00
Të hyrat e shtyera		0.00	0.00
<b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>		<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	8	0.00	0.00
Huatë e pagueshme		1,120.00	10,445.00
Detyrimet tjera afatshkurtra	9	0.00	0.00
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>		<b>1,120.00</b>	<b>10,445.00</b>
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>1,120.00</b>	<b>10,445.00</b>
<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b>		<b>1,172.92</b>	<b>4.93</b>

**Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve**

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2023	2022
<b>Të hyrat</b>			
Të hyrat nga buxheti		26,004.38	26,723.44
Të hyrat nga anëtarësia		0.00	0.00
Donacionet dhe kontributet në të holla	3	1,172.92	4.93
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	4	0.00	0.00
Të hyrat e fushatës		0.00	0.00
Te hyrat e liruar nga te hyrat e shtyera	5	0.00	0.00
Të hyrat tjera		0.00	0.00
<b>Gjithsej të hyrat për vitin</b>		<b>27,177.30</b>	<b>26,728.37</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Pagat dhe kompensimet	2	8,909.96	8,658.00
Shpenzimet e transportit	2	730.00	615.00
Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	2	2,567.30	647.57
Shpenzimet e fushatës	2	10,445.00	18,425.00
Blerja e mallrave	2	545.00	4,847.00
Shpenzimet e përgjithshme	2	3,670.26	3,627.91
Shpenzimet e ndryshme	2	256.86	352.89
<b>Gjithsej shpenzimet për vitin</b>		<b>27,124.38</b>	<b>37,173.37</b>
<b>Suficiti / (deficiti) për vitin</b>		<b>52.92</b>	<b>(10,445.00)</b>



## **1. Informata te përgjithshme**

### **Demokratska Stranka Bošnjaka - DSB**

Udhëheqja: Rasim Demiri - Kryetar i Subjektit Politik

Emo Kurtishi - Përfaqësues i autorizuar financiar

Selia e partisë: Prizren, Rr. Enver Haradinaj nr.48.

Pasqyrat financiare te **Demokratska Stranka Bošnjaka - DSB** janë përgatitur sipas kërkesave të Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L- 058, me Ligjin Nr. 04/L-212 dhe me Ligjin Nr. 08/L-122. Neni 15, Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 10 te Ligjit 08/L-122 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-212 dhe me ligjin Nr.04/L-058, Subjekti i regjistruar politik brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara ka dorëzuar raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuara nga auditorët.

Subjekti Politik, nuk posedon llogari bankare aktive në ndonjë nga Bankat Komerciale në Republikën e Kosovës. (Transaksionet kryhen me llogarinë bankare të Koalicionit VAKAT, në të cilin koalicion është pjesë edhe Subjekti Politik DSB).

## Shënimi 2. Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
<b>Pagat dhe kompensimet</b>			
Pagat dhe kompensimet, neto	7,553.48	7,553.48	0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit	414.00	414.00	0.00
Kontributet pensionale të punëdhënësit	414.00	414.00	0.00
Tatimet në të ardhura personale	528.48	528.48	0.00
Beneficionet tjera	0.00	0.00	0.00
<b>Gjithsej</b>	<b>8,909.96</b>	<b>8,909.96</b>	<b>0.00</b>
<b>Shpenzimet e transportit</b>			
Automjetet motorike të huazuara	0.00	0.00	0.00
Karburantet	560.00	560.00	0.00
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.	0.00	0.00	0.00
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave	0.00	0.00	0.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit	170.00	170.00	0.00
<b>Gjithsej shpenzimet e transportit</b>	<b>730.00</b>	<b>730.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat</b>			
Lokali	0.00	0.00	0.00
Ushqimi	2,567.30	2,567.30	0.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative	0.00	0.00	0.00
Radio dhe spotet televizive	0.00	0.00	0.00
Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	0.00	0.00	0.00
<b>Gjithsej reklammat, reprezentacioni dhe konferencat</b>	<b>2,567.30</b>	<b>2,567.30</b>	<b>0.00</b>

**Demokratska Stranka Bošnjaka - DSB**

*Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2023 deri më 31 Dhjetor 2023*

<b>Shpenzimet e fushatës</b>			
Shpenzimet e fushatës	10,445.00	9,325.00	1,120.00
<b>Gjithsej shpenzimet e fushatës</b>	<b>10,445.00</b>	<b>9,325.00</b>	<b>1,120.00</b>
<b>Blerja e mallrave</b>			
Furnizimi i zyrës	545.00	545.00	0.00
Pajisjet të vogla	0.00	0.00	0.00
<b>Gjithsej blerja e mallrave</b>	<b>545.00</b>	<b>545.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Shpenzimet e përgjithshme</b>			
Qiraja e lokalit të zyrës	2,400.00	2,400.00	0.00
Telefoni, interneti dhe posta	485.00	485.00	0.00
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	785.26	785.26	0.00
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë		////////////////////	////////////////////
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime		////////////////////	////////////////////
<b>Gjithsej shpenzimet e përgjithshme</b>	<b>3,670.26</b>	<b>3,670.26</b>	<b>0.00</b>
<b>Shpenzimet e ndryshme</b>			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	256.86	256.86	0.00
<b>Gjithsej shpenzimet e ndryshme</b>	<b>256.86</b>	<b>256.86</b>	<b>0.00</b>
<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>27,124.38</b>	<b>26,004.38</b>	<b>1,120.00</b>

**Shënimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla**

Pranuar nga				Vlera	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi	në euro	Bankë	Arkë
<b>Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla</b>				<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>

**Shënimi 4: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime**

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga				Vlera
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi	në euro
<b>Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime</b>					<b>0.00</b>

**Shënimi 5: Toka, objektet dhe pajisjet**

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fundë të vitit (vlera neto)
Toka					<b>0.00</b>
Objektet					
Veturat					
Pajisjet e zyrës					
Pajisjet e teknologjisë informative					
Pajisjet tjera					
<b>Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet</b>					

**Shënime tjera**

<b>Shënimi 6. Llogari të arkëtueshme</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2023 Shuma në Euro</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro</b>
.....		
.....		
<b>Gjithsej Llogarit e arkëtueshme</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>

<b>Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2023 Shuma në Euro</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro</b>
Paraja në bankë	1,172.92	4.93
Paraja në arkë		
<b>Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë</b>	<b>1,172.92</b>	<b>4.93</b>

<b>Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2023 Shuma në Euro</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro</b>
.....furnitori 1		
.....furnitori 2		
.....furnitori 3		
.....furnitori 4		
Llogari te pagueshme te tjera		
<b>Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>

<b>Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2023 Shuma në Euro</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2022 Shuma në Euro</b>
Detyrimet për paga dhe tatime		
Detyrimet për qira		
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime		
Detyrime tjera afatshkurtër (huazimet)		
<b>Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>

**Shënimi 10: Pagesat mbi 5,000.00 Euro**

Qëllimi i pagesës	Paguat ndaj:			Data kur është bërë pagesa	Vlera në euro
	Përsoni Fizik/Juridik	Adresa	Numri personal		
<b>Gjithsej pagesat mbi 5,000.00 Euro</b>					<b>0.00</b>